



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada - Government

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë -Ministarstvo Trgovine i Industrije - Ministry of Trade and Industry

Raporti vjetori i mbikëqyrjes së tregut 2019

Raporti vjetor i realizimit të inspektimeve të kryera nga autoritetet inspektuese të Trupit Koordinues për Mbikëqyrjen e Tregut si vijon:

Numri i inspektimeve:

Në vitin raportues u kryen gjithsejtë 1255 inspektime, nga të cilat, 795 inspektime janë kryer në mbikëqyrje pro-aktive dhe 460 inspektime në mbikëqyrje reaktive (sipas njoftimeve të RAPEX-it 50 me kërkesë nga administrata doganore 69 dhe me kërkesa të klientit 341 inspektime).

Në vitin raportues në tregun e Kosovës në monitorimin pro-aktiv dhe reaktiv u identifikuan 19 lloje të produkteve të rrezikshme në sasinë prej 4.272.616 copë.

Produktet e rrezikshme sipas kategorive të rrezikut.

Produktet e rrezikshme me rrezik serioz:

Në tregun e Kosovës, në monitorimin pro aktiv dhe reaktiv, janë gjetur produkte të rrezikshme me rrezik serioz, 6 lloje në sasinë prej: 3.637.805 copë.

Nga sasia e deklaruar, Inspektorati i tregut gjeti, 3 lloji në sasinë prej 190 copë produkte: Vlesë elektrike për gatime-Scarlet: (1 lloje/41copë), Bateri laptopi-notebook HP:(1 lloji /2 copë), Helmeta-kapela-pune:(1 lloji /147copë).

Inspektorati i Energjisë gjeti, 1 lloje në sasinë prej12 copë produkte: Rezervuar gazi të lëngëzuar-gln-së. (1 lloji / 12 copë),

Inspektorati Farmaceutik: 2 lloji në sasi prej:3.637.603 copë produkte: Ranital tab.150 mg (1 lloji/ 3.635.980 copë), Ranitidin efervete 75mg, (1 lloji / 1.623 copë).

Produkte që nuk paraqesin një rrezik serioz:

Në tregun e Kosovës, në monitorimin pro aktiv dhe reaktiv u gjetën 13 lloje, në sasinë prej: 634.811 produkte që nuk paraqesin një rrezik serioz.

Nga sasia e deklaruar, Inspektorati i Tregut gjeti, 6 lloje produkte; Pajisje makinerisë, 90 copë produkte: (Kompresorë ajri MB W221: (1 lloji / 2 copë), Amortizera ajri Audi A8 D3 4E: (1 lloji / 2 copë), Amortizerë ajri BMWx5x6GT: (1 lloji / 34 copë), Amortizerë ajri LR3: (1 lloji /1 copë), Amortizerë ajri MB W251: (1 lloji /50 copë), Amortizerë ajri VW Phaeton: (1 lloji /1 copë),

Agjencia e Metrologjisë së Kosovës gjeti, 4 lloji produkte: Mjete matëse ligjore 409 copë: (Distributor te karburanteve të naftës, 38L/min. Global Starë. HR 2005: (1 lloji /2 copë), Peshore elektronike, deri ne 30 kg: (1 lloji /177 copë), Peshore elektronike e dorës, deri ne 10 kg: (1 lloji / 30 copë), Ujëmatës për matjen e rrjedhjes së ujit deri 10 m³/h: (1 lloji /200 copë),

Inspektorati Farmaceutik gjeti, 3 lloji produkte: Produkte medicina-le: (Salbautamoll, tretësirë 2mg/ml: (1 lloji / 80.370 copë), Biosutra, gel.100mg: (1 lloji / 53.942 copë), Tramoll, tab 200 mg: (1 lloji /500.000 copë).

Inspektorati për Pajisje nen Presion, Inspektorati Nacional për Substancat Eksplozive, Substancat e Ndezshme, nuk ka gjetur produkte të rrezikshme që paraqesin një rrezik serioz.

Masat:

- Tërheqja e produktit të rrezikshme me rrezik serioz nga tregu dhe ndalimi përhershëm, 6 lloje në sasinë prej, 3.637.805 copë,
- Ndalimi i përkohshëm i qarkullimit dhe shkatërrimi, 13 lloji në sasinë prej, 634.811 copë, produkte të cilat nuk paraqesin një rrezik serioz.
- Masa detyruese te shkatërrimit, për (6) lloje të produkteve të rrezikshme me një rrezik serioz prej, 3.637.805 copë.

Shkurt, 2020

Me respekt,

Ruzhdi Shehu,
Zëvendës Kryesues i TKMT